



Република Северна Македонија
Republika e Maqedonisë së Veriut

АПЕЛАЦИОНЕН СУД ГОСТИВАР ГЈУКАТА Е АPEЛИТ ГОСТИВАР

Ул. Живко Брајковски бр.1, 1230 Гостивар / тел: 042-221-544 / info@asgostivar.mk
Rr. Zhivko Brajkovski nr.1, 1230 Gostivar / tel: 042-221-544 / info@asgostivar.mk

AGJ.nr.364/22
Data:01.11.2022
Gostivar

Kryetari i Gjykatës së Apelit Gostivar, Bekim Mehmedi, në pajtim me nenin 119 nga Rregullorja e Gjykatës ('Gazeta Zyrtare e RM' nr.66/13 dhe 114/14) dhe nenin 88 paragrafi 1 dhe 2 nga Ligji për Gjykatat ('Gazeta Zyrtare e RMV' nr.58/06 dhe 96/19), solli vendimin e mëposhtëm:

RENDI SHTËPIAK

Neni 1

Me rendin shtëpiak vërtetohet mënyra e shfrytëzimit të hapësirave të punës, mirëmbajtja e rendit dhe higjienës, nevojat e duhura për sigurinë e hapësirave dhe masa të tjera për rruajtjen e mjeteve të punës dhe mjeteve të cilat gjenden në gjykatë, si dhe detyrat për kujdesin e sigurisë së hapësirave të gjykatës.

Rendi shtëpiak formulohet për shkak të realizimit të kushteve optimale për punë për të punësuarit në gjykatë, me qëllim që të ketë qasje më të lehtë të qytetarëve për realizimin e të drejtave të tyre në gjykatë.

Neni 2

Rregullat e rendit shtëpiak u përkasin dhe janë detyrë e të punësuarve në hapësirat e gjykatës dhe atë: të punësuarit në Gjykatën e Apelit Gostivar, për palët, personat e autorizuar të palëve, përfaqësues dhe mbrojtës, pjesëmarrës të tjerë në procedurat gjyqësore, si dhe të gjitha personat e tjerë të cilët për çfardo rasti gjenden brenda në hapësirat e gjykatës.

Neni 3

Rregullat e brendëshme të hapësirave të gjykatës përfshijnë:

- Mënyrën e shfrytëzimit të orarit të punës në gjykatë,
- Mënyrën e shfrytëzimit të hapësirave të punës dhe hapësirave të tjera në gjykatë,
- Hyrja dhe qëndrimi në hapësirat e gjykatës,
- Sigurimi i hapësirave të gjykatës dhe personave në të,
- Sjellja e të punësuarve në gjykatë,
- Fotografimi, regjistrimi audio dhe video.

MËNYRA E SHFRYTËZIMIT TË ORARIT TË PUNËS NË GJYKATË

Neni 4

Orari i punës në gjykatë është nga ora 07:30 deri në ora 15:30 .

- Pushimi gjatë orarit të punës është nga ora 11:00 deri në ora 11:30.

- Periudha kohore për punë me palët në sekretariatë gjyqësore është nga ora 08:30 deri në ora 14:00.

- Orari i punës në sekretariatë për palët është nga ora 07:30 deri në ora 15:30 .

Të punësuarit në gjykatë janë të detyruar që t'i përmbahen orarit të punës dhe të jenë në vendet e tyre pa ndalim të panevojshëm në hapësirat e tjera të gjykatës.

Të punësuarit janë të detyruar që gjatë arrdhjes në punë dhe shkuarjes nga puna, si dhe gjatë shfrytëzimit të pushimit, dalje zyrtare dhe mungesa të arsyetueshme gjatë ditës të evidentohen me kartelën për evidencë elektronike në orarin e punës.

Mungesa gjatë ditës mund të shfrytëzohet me leje të parakohshme të kryetarit të gjykatës, administratorit të gjykatës ose personit të autorizuar.

Pas orarit të punës mund të ngelen në ndërtesë të punësuarit që gjatë asaj kohe i kryejnë punët e tyre (pastrues), ndërsa të punësuarit e tjerë në pajtim me nevojat e pazakonshme për kryerjen e detyrave.

Kryerja e punëve të rregullta jashtë orarit të punës dhe ditës e jo punës, të punësuarit në gjykatë e kryejnë me leje të parakohshme të kryetarit të gjykatës, administratorit të gjykatës ose personit të autorizuar.

Jashtë orarit të punës, të punësuarit mund të hyjnë në ndërtesë me lajmërim të parakohshëm te personi zyrtar, i cili është i detyruar të evidentojnë kohën e hyrjes dhe daljes si dhe arsyet e hyrjes.

MËNYRA E SHFRYTËZIMIT TË HAPËSIRAVE TË PUNËS DHE HAPËSIRAVE TË TJERA DHE MJETET E PUNËS NË GJYKATË

Neni 5

Të punësuarit në gjykatë janë të detyruar t'i shfrytëzojnë hapësirat dhe mjetet e punës me vëmendje dhe kujdes.

Hapësirat e punës, korridoret dhe hapësirat e tjera në ndërtesën e gjykatës duhet të jenë në gjendje të mirë, të pastërta, të furnizuara me mjete higjienike dhe me aparat zjarrfikësi.

Në sallën e gjykimeve, sekretariatë dhe hapësirat e tjera zyrtare është e ndaluar të bëhet aktivitet tjetër ose mbajtja e mjeteve të cilët nuk janë në funksion për kryerjen e veprimtarisë bazë të gjykatës.

Në hapësirat punuese dhe korridoret e gjykatës nuk është e lejuar të bëhet zhurmë e panevojshme, bisedë me zë të lartë dhe qeshje me çka do të prishej procesi punues.

Nuk është e lejuar nxjerrja e mjeteve bazë dhe mobiljeve nga ndërtesa e gjyqit, përpos në rast të rregullimit të tyre dhe servisimit, me leje.

Nuk është e lejuar shfrytëzimi i materialit të zyrave për nevoja personale.

Vetura zyrtare e gjyqit mund të shfrytëzohet vetëm për nevoja zyrtare me leje të parakohshme të kryetarit të gjyqit.

Neni 6

Hapësirat e gjykatës, gjatë orarit të punës mbyllen në raste kur në to nuk gjenden të punësuarit e gjyqit.

Pas kryerjes së orarit të punës lëndët, materialet zyrtare, mjetet e zyrës, mjete të tjera me vlerë më të madhe, vulat dhe shtembillat mbyllen .

Të gjitha hapësirat patjetër të kenë çelësa shtesë të cilat rruhen te personi zyrtar.

Të punësuarit janë të detyruar që para lëshimit të hapësirave të punës të kontrollojnë nëse janë të mbyllura dritaret, dritat nëse janë të çkyçura, aparatet dhe mjetet elektrike.

HYRJA DHE QËNDRIMI NË GJYKATË

Neni 7

Për hyrje dhe dalje në gjykatë, të punësuarit dhe palët e shfrytëzojnë të njejtën hyrje (të vetmen).

Gjatë hyrjes së palëve, personi i autorizuar është i detyruar të kryejë kontroll të dokumenteve të identifikimit, ndërsa nëse bëhet fjalë për person pa ftesë për seancë evidentohet hyrja dhe arsyeja për hyrjen e tyre në gjykatë. Perderisa bëhet fjalë për persona të cilët janë të thirrur në seancë, është e detyrueshme të kryhet inspektim i ftesave dhe të drejtohen në vendin ku janë thirrur.

Nëse pala e cila kërkon të pranohet të kryetari i gjyqit, gjykatësi ose administratori gjyqësor ose te të punësuarit e tjerë në gjykatë, është e detyrueshme të paralajmërohet pala dhe të drejtohet përderisa është bërë pranimi i hyrjes.

Për persona në gjendje të alkoolizuar dhe nën ndikim të narkotikëve, nuk do të ju lejohet hyrje në gjykatë.

Ndalohet qëndrimi i palëve pas mbarimit të nevojës për praninë e tyre në gjykatë.

Në sallën e gjykimeve dhe hapësirat për shqyrtim të shkresave është e ndaluar të përdoret telefoni celular.

Neni 8

Në hapësirat e gjykatës nuk është e lejuar konsumimi i pijeve alkoolike, ndërsa në korridore nuk është e lejuar të konsumohet edhe ushqim.

Nëpunësve gjyqësor nga sekretaritë nuk është e lejuar të përdorin ushqim gjatë punës me palë.

Rreptësisht është e ndaluar pirja e cigares në hapësirat e gjyqit, përpos në hapësirën e përcaktuar për cigare.

SIGURIMI I HAPËSIRAVE TË GJYQIT DHE PERSONAVE NË TË

Neni 9

Vrojtimin mbi levizjen e personave të cilët qëndrojnë në hapësirat e gjyqit e kryejnë personat e policisë gjyqësore (në momentin kur nuk ka pjesmarrës të policisë kryhet nga ana e të gjithë të punësuarve) përmes vrojtimit dhe përmes sistemit të kamerave.

Policia gjyqësore e mban rendin në gjykatë, mbron jetën dhe të gjithë të pranishmit në hapësirat e gjykatës.

Pas kryerjes së orarit të punës për sigurinë e ndërtesës dhe pronës së gjyqit përgjigjet policia gjyqësore e Gjykatës Themelore Gostivar.

Policia gjyqësore gjatë hyrjes së personave të tjerë në gjykatë mund të kryejë kontroll të personave dhe kontroll të mjeteve me të cilat ato hyjnë në gjykatë.

Është e ndaluar të futet armë zjarri ose ndonjë lloj tjetër arme në gjykatë. Personat të cilët mbajnë armë zyrtare gjatë hyrjes në ndërtesën e gjykatës janë të detyruar të dorëzojnë armët te policia gjyqësore.

Nëse palët ose personat e tjerë e thyejnë rendin dhe paqen në hapësirat e gjyqit, do të merren masa adekuate.

Në hapësirat zyrtare është e ndaluar ndalimi i punëtorëve, palëve dhe personave të tjerë.

SJELLJA E TË PUNËSUARVE

Neni 10

Të punësuarit në gjykatë janë të detyruar që në raportet mes tyre të veprojnë me kujdes dhe respekt, të bashkëpunojnë dhe të kontribuojnë në avansimin e raporteve profesionale dhe atmosferës së punës, duke i'u ikur veprimeve të cilat do të kishin pasoja të dëmshme në reputacionin e gjyqit.

Të punësuarit në gjyq janë të detyruar që ndaj palëve dhe personave të tjerë të cilët vijnë në gjykatë të veprojnë me profesionalizëm dhe me paanshmëri, duke mbajtur llogari që të ju jepet qasje më e lehtë për realizimin e të drejtave të tyre.

Të punësuarve në gjykatë nuk i'u lejohej të komentojnë me palët për rregullsinë dhe rrjedhën e procedurës gjyqësore, vendimit gjyqësor ose rezultatin e mosmarveshjes.

RREGULLAT E VESHJES

Neni 11

Palët të cilët hyjnë në gjykatë patjetër të jenë të veshur në mënyrë adekuate, në të kundërtën nuk do të ju lejohet hyrja në gjykatë.

Të punësuarit në gjykatë janë të detyruar të jenë të veshur në mënyrë adekuate zyrtare. Me veshjen e tyre ata nuk duhet të shkaktojnë përshtypje të turpshme dhe të prishet reputacioni i gjyqit. Është e ndaluar që të punësuarit të veshin: veshje sportive (trajnere), dollake, funda të shkurtër, pantollona mbi gjunj, dekolte të thella, ndërsa shpatullat dhe mesi duhet të jenë të mbuluara.

FOTOGRAFIMI DHE REGJISTRIMI AUDIO DHE VIZUEL

Neni 12

Fotografimi dhe regjistrimi audio dhe vizuel në hapësirat e gjykatës mund të kryhet vetëm me leje me shkrim nga kryetari i gjyqit.

DISPOZITA PËRFUNDUESE

Neni 13

Rendi shtëpiak është dërguar në mënyrë elektronike te të punësuarit, me qasje në 'Dosjen e përbashkët' dhe është i vendosur në hapësirat e gjykatës.

Neni 14

Mosrespektimi i dispozitave të rendit shtëpiak nga ana e të punësuarve në gjykatë, në bazë të ligjit sjell pasoja të masave disiplinore.

Neni 15

Rendi shtëpiak hyn në fuqi në ditën e miratimit të tij.

Përgaditur nga :
Sedulla Memedi

Kryetari i Gjykatës së Apelit
Gostivar
Bekim Mehmedi